



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

Legjislatura VIII  
*Sesioni pranveror*

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**  
P-nr.91/2024  
Prishtinë, më 3.6.2024, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Arjeta Fejza, Albana Bytyçi, Drita Millaku, Fatmire Kollçaku, Labinotë Demi- Murtezi, Ariana Musliu- Shoshi, Eliza Hoxha dhe Duda Balje.

Munguan: Nasuf Bejta dhe Marigona Geci.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e lartë në Komision.

Pjesëmarrës të tjerë: Labinot Bala, Komisioni Qeveritar, Nazmije Kajtazi-anëtare e Komisionit Qeveritar, Leonora Selmani-kryetare e Komisionit Qeveritar, Mentor Borovci, anëtar i Komisionit Qeveritar, Shpend Haxhibeqiri, anëtar i Komisionit Qeveritar; Marigona Pajaziti, Kuvendi i Kosovës; Gent Ramosaj, GP AAK; Celal Ilyas, Kuvendi i Kosovës; Kaltrina Ibërdemaj, GP LVV; Shqipe Pajaziti, Kosova Press; Gentiana Kadrija, Radio Evropa e Lirë; Valjeta Shala, RTK; Natyra Salihaj, Ekonomia Online; Teuta Prekazi, UNOIK/OHCHR; Blerina Istrefi, GLPS; Antigone Isufi, Kallxo.com; Besarta Pllana, Kuvendi i Kosovës dhe Zgjim Sefa, Indexonline.

Mbledhjen e kryesoi Arjeta Fejza, nënkryetare e parë e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim në Komision lidhur me procesin e verifikimit të aplikacioneve të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës;  
Të ftuar: përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës.
3. Të ndryshme.

\*\*\*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Nënkryetarja** konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Më pas, njoftoi se një pjesë e mbledhjes do të mbahet pa prezencën e mediave.

## **2. Diskutim në Komision lidhur me procesin e verifikimit të aplikacioneve të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës;**

### **Të ftuar: përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës**

**Nënkryetarja** falënderoi pjesëmarrësit në këtë takim dhe më pas ia dha fjalën kryetares së Komisionit Qeveritar.

**Leonora Selmani**, njoftoi se Komisioni Qeveritar, edhe këtë vit, ka vazhduar punën me ritëm të shpejtë, kanë mbajtur takime të rregullta javore, por kanë mbajtur edhe takime të tjera të nevojshme, ashtu siç i kanë të përcaktuara me rregullore, sepse në bazë të rregullores së punës mund të mbajnë takime sa herë që iu duket e nevojshme dhe sa herë që sekretaria njofton se kanë raste më shumë që janë duke pritur apo ka raste urgjente.

Ajo tha se për dallim nga vitet e tjera, në këtë vit kanë më shumë raste që janë të gjykatës, sepse janë raste që kanë shkuar në gjykatë dhe kthehen në komision për rishqyrtim dhe rivendosje apo edhe ndryshe, ndërsa procesi i aplikimit ka vazhduar me rrjedhën e njëjtë me vitet tjera. Është mirë që është vazhduar edhe afati i aplikimit edhe për dy vite, sepse është dëshmuar se ka pasur nevojë, sepse po vazhdohet ende me aplikimet dhe është dashur të mendohet edhe për dy vite të tjetra shtesë, në bazë të dhënave që i kanë deri më tani.

Ajo njoftoi se edhe në këtë vit kanë bashkëpunuar me organizatat e shoqërisë civile, të cilat ndihmojnë në këtë proces dhe që janë të licencuara nga Qeveria për plotësimin e aplikimit dhe formularëve që ofrojnë të dhëna dhe dokumente për viktimat, te komisioni. Qeveria edhe një herë ka bërë marrëveshje mirëkuptimi me këto OJQ, për vitet në vazhdim, edhe për dy vitet e tjera. Në bazë të ligjit, afati i fundit për aplikim është 15 maj 2025, me mundësi vazhdimi edhe për dy vite të tjera, ndërsa komisioni, sipas vendimit të Qeverisë, e ka afatin deri në prill të vitit 2025.

Tha se prej momentit kur kanë filluar t'i pranojnë aplikimet e deri më sot, në total i kanë 2083 raste, prej të cilave të aprovuara janë 1650, ndërsa të refuzuara janë 316, në pritje për intervistë janë 40 raste, prej këtyre 40 rasteve një pjesë janë jashtë vendit, një pjese janë që kërkojnë kohë që t'iu jepet mundësia për të ardhur më vonë. Të trajtuara në total janë 2033 raste deri më tani dhe aktualisht presin përgjigje edhe 50 raste, të cilat ende nuk i ka trajtuar komisioni dhe janë në radhë për t'u trajtuar. Po ashtu, shtoi se në vitin 2024, deri tani kanë pranuar 81 aplikime.

**Fatmire Kollçaku**, tha se lut anëtarët e komisionit, në emër të gjithë atyre që mendojnë të aplikojnë që për ics arsye nuk kanë aplikuar dhe të gjithë i dinë se cilat janë ato arsye, që të kihet parasysh sidomos atë pjesën emocionale, sepse dihet se sa e vështirë është që dikush të dalë dhe të identifikohet si dikush që e ka përjetuar këtë dhunë, që ka qenë një dhunë sistematike e përdorur dhe fatkeqësisht ende po përdoret në luftëra.

**Leonora Selmani**, tha se te ndërgjegjësimi i opinionit publik ka nevojë për të punuar më shumë, bashkërisht, të gjithë. Tha se si komision, vitin e fundit kanë punuar më shumë në këtë drejtim, krahasuar me vitet e tjera, kanë bërë tri reklama televizive. Po ashtu, edhe nëpër rrjete sociale, kanë bërë edhe një fushatë për 10 ditë radhazi, ku edhe në rrjete sociale të komisionit dhe rrjete

tjera sociale, është qartësuar procedura se ka mundur të kalojë një viktimë e mundshme, në mënyrë që të mund të vjen deri te njohja e statusit.

**Arjeta Fejza**, tha se si komision e ndajnë të njëjtin shqetësim, sa i përket ndërgjegjësimit dhe e thonë vazhdimisht se bashkërisht duhet të kontribuojnë në këtë drejtim, sepse është përgjegjësi e të gjithëve, që të angazhohen sidomos në luftimin e stigmatizimit dhe duhet ofruar përkrahje të nevojshme kësaj kategorie të personave.

**Ariana Musli- Shoshi**, tha se i intereson të di lidhur me 18 rastet që janë kthyer nga gjykata, se sa prej tyre kanë vendim të ndryshëm nga ai që ka marr Komisioni Qeveritar. Fillimisht, u tha se 181 raste janë të paraqitura në vitin 2023, që nga fillimi i punës tuaj, 181 raste a janë më pak apo më shumë, krahasuar me vitet e tjera, ndërsa sa i përket afatit për aplikim, tha se nuk është afat i mjaftueshëm dhe beson se ky afat duhet të zgjatet.

**Leonora Selmani**, tha se 18 rastet e kthyer nga gjykata, i ka kthyer për rivendosje dhe në momentin kur kemi marrë vendimin prapë, gjykata për 18 prej tyre, ka vendosur ashtu siç ka vendosur komisioni. Pra, gjykata i ka dhënë të drejtë komisionit dhe prej këtyre 18 lëndëve, 5 prej tyre kanë shkuar edhe në Gjykatën e Apelit dhe kjo gjykatë prapë i ka kthyer me të njëjtin kuptim. Vlen të përmendet se Gjykata Themelore, tri lëndë i ka vendosur në favor të viktimave, dhe këto raste janë raste që në momentin kur e kanë dërguar lëndën në gjykatë, kanë dërguar dokumente të cilat në komision nuk i kanë pasur më parë. Në vitin 2024, deri tani, i kemi 81 raste, në vitin 2023 i kishim 131 raste, në vitin 2022 ishin 249 raste, në vitin 2021 ishin 229, në vitin 2020 ishin 204, në vitin 2019 ishin 268 dhe 2018 ishin 921 raste.

**Drita Millaku**, u interesua të dijë lidhur me tri rastet që i ka kthyer gjykata, në favor të palëve. Pra, u tha se janë dorëzuar edhe dokumente të tjera shtesë në gjykatë, të cilat në komision nuk kanë qenë në kohën kur komisioni ka shqyrtuar dhe refuzuar lëndën, por për këtë, zonja Leonora dha përgjigje më herët.

**Eliza Hoxha**, tha se meqenëse viktimat e kanë të qartë se çfarë dokumentesh duhet t'i sjellin në komision dhe e ka rrugën e qartë se si të vijë deri te përfitimi i këtij statusi. Pyeti: pse nuk i ktheni një përgjigje se si duhet plotësuar dokumentet, pse duhet pritur për të shkuar në një shkallë tjetër për t'u siguruar një dokument?

**Leonora Selmani**, tha se gjykata është institucion vendimmarrës, ndërsa vendimet e komisionit janë më shumë procedurë administrative. Në momentin kur pala aplikon, e ka të ditur se çka duhet të sjellë, nëse nuk e ka të ditur, janë shoqatat e shoqërisë civile, por edhe sekretaria e komisionit, të cilët i ndihmojnë në plotësimin e aplikacionit dhe formulari i aplikimit i përmban në pika të trasha të gjitha ato çka duhet të përmbajë. Ne u kërkojmë dokumente shtesë, nëse mund t'i dërgojnë dhe ju japim afat shtesë për t'i sjellë.

**Labinothë Demi- Murtezi**, tha se herëve të kaluara kanë biseduar për mundësi bashkëpunimi dhe kemi kërkuar që bashkërisht të dalim dhe të punojmë në terren, në kuptimin e sensibilizimit për të aplikuar, duke pasur parasysh se stigma, paragjykimet e tjera, bëjnë që njerëzit të ngurrojnë të aplikojnë e të deklarojnë se janë viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit. Ajo pyeti: A mundemi së bashku me Komisionin Qeveritar ta bëjmë një premtim publik, se si do të bashkëpunojmë në këtë drejtim? Pra, të bëhen vizita në të gjitha qytetet e Kosovës, sepse është një jehonë ndryshe dhe një lehtësim për të ardhur deri te dorëzimi i një aplikacioni edhe në këtë formë duke dalë në terren. Në vijim, pyeti: Pse palët nuk e sjellin dokumentacionin që e dërgojnë në gjykatën fillimisht edhe në komision, pasi që ju jeni të thirrur ekskluzivisht vetëm për këtë çështje?

**Leonora Selmani**, tha se gjithmonë kanë qenë dhe janë të hapur për të bashkëbiseduar për të sqaruar shumë çështje që janë të nevojshme. Tha se me shoqërinë civile kanë shkuar nëpër të gjitha rajonet dhe thuajse në të gjitha komunat ku kanë mbajtur takime me qytetarët dhe këtë mund ta bëjmë prapë bashkërisht me Komisionin parlamentar. Në vijim, tha se janë munduar gjatë kësaj kohe të jenë aktivë edhe nëpër media. Lidhur me dokumentin që palët e dërgojnë në gjykatë e jo në komision, tha se kjo është ekskluzivisht e drejtë e palës në procedurë, por gjykata mund të vendosë edhe pa dërguar dokument shtesë, mbi bazën e dokumenteve që kanë qenë në komision.

**Fatmire Kollçaku**, pyeti lidhur me rastet e pambyllura se a ktheheni në revidim të rasteve dhe me OJQ-të, që janë respektabile e që janë marrë ndër vite me këtë çështje që kanë qenë në kontakt me këto viktime. A ka nivel të mirë të bashkëpunimit me këto OJQ dhe a mund të përforcohet ende ky bashkëpunim, me qëllimin më të mirë që t'iu ndihmohet viktimave?

**Leonora Selmani**, tha se sa i përket bashkëpunimit me shoqërinë civile, konsideron se e kanë shumë të mirë dhe beson se do të vazhdoj edhe në të ardhmen. Me shoqërinë civile, tha se i mbajnë takimet e rregullta, sepse ata janë të thirrur për t'iu ndihmuar viktimave në procesin e aplikimit dhe për ta ndihmuar komisionin.

**Albana Bytyçi**, tha se janë 316 raste të refuzuara dhe janë në pritje për intervistë 47 raste, mirëpo totali i përgjithshëm është 2083 raste. Çka është bërë me këto 316 raste, a vetëm janë refuzuar apo a jeni marrë përsëri me to dhe a ka ndonjë rast që ka sjellë gjykata për rishqyrtim dhe ju e keni aprovuar?

**Leonora Selmani**, tha se me këto 316 raste janë marrë disa herë dhe prej këtyre ka raste që deri në 6 herë është shqyrtuar, nuk është që është refuzuar një herë dhe ka përfunduar, sepse në momentin kur refuzohet për herë të parë, pala e ka të drejtën e ankesës për rishqyrtim, mund të kalojë lënda herën e dytë. Çdo rast trajtohet veç e veç dhe secili rast e ka trajtimin e duhur. Kur rasti vjen në rivendosje nga gjykata, tha se ju jepet mundësia për t'u marrë prej fillimit, pra edhe një herë me rastin.

**Kryetrajja**, tha se kriteret që janë të vendosura në letër, që secilën viktimë duhet respektuar dhe kriteret që janë në kompetencë. Sa është përqindja që ju mund të merrni vendim për një palë? Sepse, viktimat që janë ankuar te komisioni, më së shumtë kanë ankesa te momenti emocional, janë ankuar në sjelljet e anëtarëve të Komisionit Qeveritar. A keni diskutuar mes veti ndonjëherë në komision, a keni pasur ndonjë pikëpyetje në vendimet e juaja? Ajo tha se ju duhet të jeni shumë të kujdesshëm në marrjen e vendimeve, sepse vendoseni që një palë për t'i thënë se je viktimë apo nuk je viktimë.

**Leonora Selmani**, tha se është shumë e vështirë edhe nga ana e komisionit, sepse kur është diçka bardh dhe zi, është shumë lehtë për të marrë vendimin. Për raste të caktuara, mblihdemi në dytri takime të radhës. Shoqëria civile e sjell rastin duke e verifikuar, duke e parë dhe e marrin si të mirëqenë dokumentin që e ka sjellë OJQ. Gjithmonë, qasja ndaj viktimave është sfiduese. Të gjithë së bashku, gjithmonë do të mundohmi për të pasur një qasje sa më të mirë ndaj viktimave. Qasja është problematike, sepse ka të bëjë me viktimat e ndjeshme dhe nuk është e lehtë të bisedohen çështjet me persona të ndjeshëm, por kanë arritur në kuptimin më të mirë për të punuar në këtë drejtim, duke iu ofruar qasje dhe mundësi sa më të mirë viktimave, për t'u shprehur para komisionit.

**Arjeta Fejza**, në prani të mediave, edhe një herë njoftoi se deri në maj 2025, mbetet i hapur afati për aplikim për verifikimin dhe njohjen e statusit të viktimave seksuale të luftës. Po ashtu, kanë mbështetjen e Komisionit parlamentar, të Komisionit Qeveritar dhe të shoqërisë civile.

Ajo njoftoi se pjesa tjetër e takimit do të jetë e mbyllur për media dhe palët e treta.

Komisioni vazhdoi takimin me dyer të mbyllura.

### **3.Të ndryshme.**

Në këtë pikë të rendit tël ditës nuk u ngrit asnjë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Duda BALJE,  
Kryetare e Komisionit